

Një kuadrat është i përbërë nga 49 kuadratë të bardhë të gjithë të njëjlojtë mes tyre. Ngjyrosen vetëm kuadrat e bordurave me ngjyrë të kuqe. Gjeni sa kuadratë të bardhë ngelen?


- A. 16
- B. 36
- C. 21
- D. 25
- E. Nuk e di

Nxënësit e një klase kanë ndarë disa shkronja të alfabetit sipas rregullit të mëposhtëm: shkronjat janë ekuivalente nëse kanë të njëjtin numër vijash të mbyllura dhe degësh. Këndet nuk influencojnë. Për shembull, shkronjat A, e R sipas këtij rregulli janë ekuivalente pasi kanë të dyja nga një vijë të mbyllur dhe dy degë të hapura. Në të njëjtën mënyrë, për shembull, C, J, M, S, V, e Z janë ekuivalente pasi janë të ndërtuara nga një vijë e vetme e vazhduar pa degë dhe pa vija të mbyllura. Cila nga shkronjat e mëposhtme është ekuivalente me shkronjën " Y " sipas rregullit të mësipërm? **ABCDEFGHIJKLMN OPQRSTUVWXYZ**

- A. E
- B. H
- C. K
- D. N
- E. Nuk e di


Nëse trekëndëshi ABC është në shkallë 1:2 dhe trekëndëshi AFG është në shkallë 2:1, në çfarë shkalle është vizatuar trekëndëshi AED?

- A. Shkalla 1:1
- B. Shkalla 1:10
- C. Shkalla 1:50
- D. Shkalla 1:75
- E. Nuk e di



Nisur nga figura, cila aksonometri është përdorur për paraqitjen e objektit?

- A. Dimetri Ballore
- B. Izometri
- C. Dimetri Horizontale
- D. Trimetri Ballore
- E. Nuk e di



Përveç impresionizmit dhe ekspresionizmit në pikturë njihet edhe stili i kubizmit, në piktura shndërrohet çdo gjë e natyrës në formë gjeometrike. Kubizmi ishte rrymë revolucionare e artit modern, rryma e parë e artit abstrakt që u zhvillua në fillim të shekullit të XX si përgjigje ndaj botës që po ndryshonte me shpejtësi të madhe. Cili është përfaqësuesi shqiptar i kësaj rryme me famë ndërkombëtare?

- A. Vangjush Mio
- B. Ibrahim Kodra
- C. Spiro Kristo
- D. Sali Shijaku
- E. Nuk e di

Cili nga këto ndërtime simbolizon fuqinë e Faraonit?

- A. Fari i Aleksandrisë
- B. Gjigandi i Rodit
- C. Kulla Eiffel
- D. Piramida
- E. Nuk e di





Katedralet më të larta u ngritën sipas stilit.

- A. Romënik
- B. Klasik
- C. Bizantin
- D. Gotik
- E. Nuk e di

Agora në Greqinë e lashtë quhej:

- A. Ndërtesa e Asamblesë
- B. Sheshi kryesor i qytetit
- C. Pallati i sundimtarit
- D. Teatri më i madh
- E. Nuk e di

Në figurë paraqitet projektioni horizontal i një trupi gjeometrik të thjeshtë. Cila nga figurat e mëposhtme tregon pamjen ballore të tij?



E. Nuk e di

Projektioni Horizontal





Figura e mëposhtme tregon:

- A. Rakordim të jashtëm
- B. Rakordim të brendshëm
- C. Rakordim të jashtëm dhe të brendshëm
- D. Asnjëra
- E. Nuk e di



Zhan Zhak Ruso, filozof, sociolog, teoricien i pedagogjisë dhe iluminist i shquar francez, në veprën "Gjykime mbi prejardhjen dhe bazat e pabarazisë midis njerëzve", ishte i pari që lidhi pabarazinë sociale me lindjen e pronës private. Cili është mendimi i Zhan Zhak Ruso-së mbi pronën private?

- A. Prona private është e drejtë e individit
- B. Prona private është mundësi për zhvillim
- C. Prona private është e trashëgueshme
- D. Prona private është kundër ligjit të natyrës
- E. Nuk e di

Të mohosh që "çdo qen ka të paktën një pronar" është ekuivalente me shprehjen :

- A. të gjithë qentë nuk kanë pronarë
- B. të gjithë janë pronarë të çdo qeni
- C. çdo qen nuk ka një pronar
- D. ekzistojnë qen që nuk kanë pronarë
- E. Nuk e di

Grupet e gjakut për herë të parë u përshkruan në vitin 1901 nga Karl Landsteiner, ato ndahet në katër grupe: A, B, AB dhe O. Gjatë tranfuzionit të gjakut, cilat nga kombinimet e mëposhtme nuk është e mundur?

13

- A. grupi O mund t'ju japë të gjithë grupeve gjak, dhe pranon vetëm nga grupi O
- B. grupi A mund t'i japë gjak grupeit A dhe AB, dhe merr nga grupi O dhe A
- C. grupi B mund t'i japë gjak grupit B dhe AB, dhe merr nga grupi O dhe B
- D. grupi AB mund t'i japë gjak grupit AB, dhe merr nga grupi O, A dhe B
- E. Nuk e di

Zonat në të cilat janë evidentuar vlera të veçanta dhe të rëndësishme, janë përfshirë në kategorinë e zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë. Cila nga zonat e mëposhtme nuk i përket kategorive të zonave të mbrojtura?

14

- A. Monument Natyror
- B. Tokë pyjore
- C. Rezervate natyrore të menaxhuara
- D. Rezervë strikte natyrore
- E. Nuk e di



Mikelanxhelo, skulptor dhe arkitekt i Rilindjes, punoi skulpturën:

15

- A. Fitorja pa krahë
- B. Kariatide
- C. Pietà
- D. Zeus
- E. Nuk e di

Tregoni figurën që kompletton serinë.

16




E. Nuk e di

Në cilin nga projektionet vijëdrejta ndodhet në madhësi të vërtetë:

17


- A.  $a'b'$
- B.  $ab$  dhe  $a'b'$
- C.  $ab$
- D. Asnjëra
- E. Nuk e di



Nga cili pozicion është bërë foto e mëposhtme?

18

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4
- E. Nuk e di



Kalaja e Bashkovës ndodhet në rrethin e:

- A. Shkodrës
- B. Kavajës
- C. Vlorës
- D. Korçës
- E. Nuk e di

19

Përmasa "b" e shkrimit teknik është:

- A. Gjerësia e shkronjave dhe e shifrave
- B. Lartësia e shkronjave dhe e shifrave
- C. Trashësia e vijës
- D. Pjerrësia e shkronjave dhe e shifrave
- E. Nuk e di


20

Gjeni diagramën që lidh më së miri marrdhënien që ekziston mes këtyre tre fjalëve: Njerëz të gjatë, Aktorë, Të diplomuar.


- A. Diagrama 1
- B. Diagrama 3
- C. Diagrama 4
- D. Diagrama 5
- E. Nuk e di



1




2




3



4



5



6

21

"Kush lexon libra dhe dëgjon muzikë klasike e do artin. Kush e do artin e do natyrën". Nëse pohimet e mësipërme janë të vërteta atëherë është e vërtetë që:

- A. kush lexon libra e do natyrën
- B. kush e do artin, dëgjon muzikë klasike
- C. kush lexon libra, dëgjon muzikë klasike
- D. kush e do natyrën e do artin
- E. Nuk e di

22

Formati A2 ka dimensione:

- A. 297 mm x 420 mm
- B. 420 mm x 594 mm
- C. 424 mm x 590 mm
- D. 421 mm x 591 mm
- E. Nuk e di

23

Në cilën stinë arrihet pjerrësia më e madhe e rrezeve të diellit në territorin Shqiptar?

- A. Pranverë
- B. Verë
- C. Vjeshtë
- D. Dimër
- E. Nuk e di

24

Harqet e Triumfit për herë të parë u ndërtuan në:


- A. Perandorinë Romake
- B. Mbretërinë Franceze
- C. Mbretërinë Egjiptiane
- D. Greqi
- E. Nuk e di

25

Figura e mëposhtme çon në zhvillimin e një kubi. Ndërsa figurat më poshtë tregojnë pesë perspektiva të kubit. Vetëm 2 prej tyre janë të mundura? Cilat prej tyre?

- A. 1 dhe 4
- B. 1 dhe 2
- C. 2 dhe 3
- D. 3 dhe 5
- E. Nuk e di

26



Kryeqendra e Perandorisë Bizantine ishte:

- A. Roma
- B. Kostandinopja
- C. Ravena
- D. Athina
- E. Nuk e di

27

Nëse do të ekzistonin vetëm monedha 1 lekëshe, 7 lekëshe dhe 8 lekëshe, cili është numri minimal i monedhave që duhen për të paguar saktësisht 60 lekë?

- A. 7 monedha
- B. 8 monedha
- C. 9 monedha
- D. 11 monedha
- E. Nuk e di

28

Cilat nga shprehjet e mëposhtme nuk është tipar i Bovarizmit?

- A. Kënaqësia nga një përvojë romantike e realizuar
- B. "Sëmundje romantike"
- C. Aspirata neurotike dhe shkatërrimtare për të qenë aty ku nuk je, për të pasur atë që nuk ke
- D. Konflikti midis iluzionit dhe realitetit, mes ëndërrave dhe mos realizimit të tyre
- E. Nuk e di

29

Sa është afërsisht distanca mesatare Tokë - Diell?

- A. 15.000.000 km
- B. 30.000.000 km
- C. 150.000.000 km
- D. 300.000.000 km
- E. Nuk e di

30

Cii nga këto objekte bën pjesë Akropolin e Athinës?

31

- A. Partenoni
- B. Teatri i Epidaurit
- C. Monumenti i Lisikratit
- D. Tempulli i Zeusit
- E. Nuk e di

Cili nga lumenjtë e mëposhtëm, të cilët përshkojnë territorin Shqiptar, nuk derdhet në detin Adriatik?

32

- A. Bistrica
- B. Shkumbini
- C. Semani
- D. Vjosa
- E. Nuk e di

"Termat Romake" në Romën e lashtë ishin:


33

- A. Gojëdhëna romake
- B. Fjalë të rëndësishme
- C. Banja publike
- D. Pazar publik
- E. Nuk e di

Figura e ndërprerjes së trupit me planin P të dhënë me gjurmë është:

34

- A. Elips
- B. Trekëndësh
- C. Hiperbolë
- D. Pjesë elipsi
- E. Nuk e di



Mbreti i perëndive në mitologjinë Greke ishte:


35

- A. Apolloni
- B. Zeusi
- C. Dionisi
- D. Poseidoni
- E. Nuk e di

Çdo figure i korrespondon një vlerë e caktuar numerike. Gjeni këtë vlerë duke pasur parasysh veprimet e mëposhtme.

36

- A. 5
- B. 4
- C. 3
- D. 2
- E. Nuk e di



Në veprën e tij "Republika", Platoni hedh idenë për një qytet në krye të të cilit duhej të qëndronte mbreti – filozof. Kështu, duke bashkuar politikën me filozofinë mund të ndërtohej një qeverisje e drejtë në interes të qytetarëve. Platoni hedh idenë për cilin qytet?

- A. Qytetin utopik
- B. Qytetin imagjinar
- C. Qytetin ideal
- D. Qytetin modern
- E. Nuk e di

Në arkitekturë, stili që lindi në shekullin e XV u quajt Rilindje sepse:


- A. Rindërtoi qytetin
- B. Risolli antikitetin
- C. Ringjalli besimin fetar
- D. Risolli fuqinë e mbretit
- E. Nuk e di

Cili nga personat e mëposhtëm nuk ka qenë president i Shqipërisë?

- A. Enver Hoxha
- B. Ramiz Alia
- C. Sali Berisha
- D. Alfred Moisiu
- E. Nuk e di


Hapjen e cilit trup gjeometrik tregon figura e mëposhtme?

- A. Kon
- B. Cilindër
- C. Sferë
- D. Kub dhe Sferë
- E. Nuk e di



Sa trekëndështa duken në figurë?

- A. 13
- B. 7
- C. 8
- D. 16
- E. Nuk e di



Sipërfaqja e faqes së një kubi është  $9 \text{ cm}^2$ . Llogarisni sipërfaqen anësore të kubit.

- A.  $18 \text{ cm}^2$
- B.  $54 \text{ cm}^2$
- C.  $36 \text{ cm}^2$
- D.  $45 \text{ cm}^2$
- E. Nuk e di

Cila është ajo figurë e kuptimit në letërsi, ku cilësitë njerëzore i vishen një kafshe, sendi a dukurie atmosferike?


43

- A. Hiperbola
- B. Personifikimi
- C. Antiteza
- D. Paralelizmi figurativ
- E. Nuk e di

Cila nga pikat e mëposhtme nuk ndodhet në të njëjtin plan:


44

- A. D dhe E
- B. Vetëm E
- C. Vetëm D
- D. Asnjëra
- E. Nuk e di




Cila nga figurat e mëposhtme paraqet saktë prerjen a-a të objektit:

45



E. Nuk e di

Objekti



Në natyrë, prezantohet modeli i trinomit të ngjyrave, ku ngjyra primare konsiderohen ato, të cilat nuk mund të përftohen nga kombinimi i asnjë ngjyre tjetër, ndërkohë që përmes kombinimit të tyre mund të arrijmë të gjitha ngjyrat e tjera dhe nuancat e tyre. Cilat janë ngjyrat primare?

46

- A. E verdhë, blu, jeshile
- B. E kuqe, e verdhë, jeshile
- C. Blu, e verdhë, e kuqe
- D. Jeshile, blu, vjollcë
- E. Nuk e di

Nëse ne marrim një numër natyror N të rastësishëm, sa është probabiliteti në përqindje që  $N^2$  të përfundojë me numrin 4?

47

- A. 0
- B. 10
- C. 20
- D. 40
- E. Nuk e di

Shtëpitë tradicionale Shqiptare mbulohen me çati. Peshën më të madhe e kanë çatitë e shtëpisë së:

48

- A. Beratit
- B. Elbasanit
- C. Shkodrës
- D. Gjirokastrës
- E. Nuk e di